

Vendim nr. 42, datë 04.02.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryetare

Asim Vokshi, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 04.02.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (Rr) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **RROLAND LULI**, përfaqësuar nga avokat Elision Sadiku.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2021-216 (31), datë 21.01.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 49, datë 01.04.2022 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2025-1025, datë 24.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, shkronja “ç”, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 142 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijues, 32 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. 598 të vitit 2019 në ngarkim të kërkuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë M.F., E.K., E.K., B.K., O.M., R.M., E.B., L.P., A.B.Q., Ç.F., për veprat penale “Trafikimi i të miturve”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Moskallëzimi i krimit”, “Përkrahja e autorit të krimit”, të parashikuara nga nenet 128/b, paragrafi 3, 278, paragrafët 1, 2 e 4, 279, paragrafi 1, 283, paragrafi 1, 284, paragrafi 2, 300 dhe 302 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-216 (31), datë 21.01.2021, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për veprat penale “Trafikimi i të miturve”, të kryer në bashkëpunim, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, i armëve shpërthyesë dhe i municionit”, “Kultivimi i bimëve narkotike”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 128/b, paragrafi 3, 278, paragrafët 1, 2 e 4, neni 284, paragrafi i 2, të KP-së, duke e dënuar me 27 vjet burgim për kryerjen e pesë veprave penale dhe, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), duke e dënuar përfundimisht me 18 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka ushtruar ankim.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 49, datë 01.04.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se ankimi i kërkuesit nuk përmbante shkaqe të tilla që të sillnin ndryshimin e atij vendimi, si për sa i përket deklarinimit fajtor të tij, ashtu edhe llojit dhe masës së dënimit.

4. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1025, datë 24.06.2025, ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

5. Në datën 11.12.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:
- 6.1. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi mbrojtësi i tij gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë ka përfaqësuar edhe nëntë të pandehur të tjerë në këtë proces, interesat e disa prej të cilëve ishin të kundërta me të tij. Edhe pse i zgjedhur prej tij, mbrojtësi ka argumentuar vetëm mungesën e elementeve të veprës penale “Trafikimi i të miturve”, pa dhënë asnjë argument për akuzën e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, pasi një qëndrim i tillë vinte në kundërshtim me interesat e të pandehurve E.K, B.K. dhe E.K., që përfaqësoheshin po nga ai.
- 6.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë arsye për mospranimin e rekursit dhe në veçanti pretendimit për mbrojtje efektive.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, vërehet se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim

kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar ai i Gjykatës së Lartë është i datës 24.06.2025, i cili sipas akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual rezulton si i është njoftuar mbrojtësit të kërkuesit në datën 16.09.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.12.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës për t’u mbrojtur dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

12. Kërkuesi ka pretenduar *cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur*, me argumentin se gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e rrethit mbrojtësi i zgjedhur prej tij ka përfaqësuar edhe nëntë të pandehur të tjerë në këtë proces, interesat e disa prej të cilëve ishin të kundërta me të tij. Sipas kërkuesit, mbrojtësi ka argumentuar vetëm mungesën e elementeve të veprës penale të “Trafikimi i të miturve”, ndërsa nuk ka dhënë asnjë argument për akuzën e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”. Po sipas kërkuesit, edhe Gjykata e Lartë nuk i ka kthyer përgjigje këtij pretendimi, duke i cenuar edhe *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*.

13. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka evidentuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se mbrojtësi duhet të veprojë në përputhje me ligjin, standardet dhe etikën e njohur profesionale për të mbrojtur të drejtat e klientit të tij, pasi kur ai vepron në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij, shkel njëkohësisht edhe të drejtën e individit për t’u mbrojtur me avokat. Në

këtë kuptim, nuk mund të bëhet mbrojtja njëkohësisht e më shumë se dy të pandehurve, nëse ndërmyet tyre ka ekzistuar papajtueshmëria e interesave (*shih vendimet nr. 15, datë 10.11.2004; nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se gjatë gjykimit në shkallë të parë kërkuesi është përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, N.T., i cili ka përfaqësuar njëkohësisht edhe nëntë të pandehurit e tjerë, ndërkohë nuk rezulton që gjatë gjykimit kërkuesi të ketë parashtruar pretendime për papajtueshmërinë e interesave të këtij mbrojtësi. Po kështu, rezulton që mbrojtësi N.T. ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së rrethit në emër të kërkuesit dhe e ka përfaqësuar atë edhe në gjykimin në apel, së bashku me mbrojtësin tjetër, E.S., të zgjedhur po prej tij, duke ngritur pretendime, si për sa i përket pabazueshmërisë dhe ashpërsisë së dënimit të dhënë nga gjykata e rrethit, ashtu edhe provueshmërisë së veprës penale “Kultivimi i narkotikëve”, të parashikuar nga neni 284, paragrafi 2, i KP-së. Pretendimet për papajtueshmërinë e interesave të këtij mbrojtësi në mbrojtjen edhe të të pandehurve L.P. dhe M.F. janë ngritur nga kërkuesi gjatë gjykimit të çështjes nga Gjykata e Apelit Korçë. Duke vënë në dukje se edhe në gjykimin para saj kërkuesi dhe i pandehuri L.P. përfaqësoheshin nga i njëjti mbrojtës, gjykata e apelit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, me arsyetimin se në gjykim kishte rezultuar e provuar se ai dhe shtetasi M.F. kishin filluar e vijuar veprimtarinë kriminale së bashku me të pandehurin L.P. dhe nuk rezultonte që këta të pandehur të kishin qëndrime të kundërta për veprën penale të trafikimit të të miturve, në kuptimin që vepra t'i atribuohet njërit dhe të mohohet nga të tjerët; si gjatë gjykimit në rreth, ashtu edhe në ankim, qëndrimi i kërkuesit dhe këtyre të bashkëpandehurve për akuzën ishte i njëjtë, duke kundërshtuar kryerjen prej tyre të veprës penale e provueshmërinë e saj. Për pasojë, ata nuk

ndodheshin para papajtueshmërisë së interesave që do të përbënte pengesë për mbrojtjen e tyre nga i njëjti mbrojtës (*shih paragrafin 73 të vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë*). Ky qëndrim është gjetur i drejtë në vijim edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka vlerësuar se argumentet e dhëna në rekurs nuk ishin të mjaftueshme për konstatimin e papajtueshmërisë së interesave të mbrojtësit, në kuptim të nenit 54 të KPP-së (*shih paragrafin 38 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës Lartë*).

16. Nga sa më lart, Kolegji çmon se, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, avokati i zgjedhur nga ai e ka ushtruar funksionin e tij mbrojtës, duke kundërshtuar dënimet e dhëna ndaj kërkuesit për veprat penale të parashikuara nga nenet 278, paragrafët 1, 2 e 4 dhe 284, paragrafi 2, të KP-së. Po kështu, si gjatë gjykimit të çështjes nga gjykata e rrethit, ashtu edhe në gjykimin në apel, kërkuesi kishte pranuar të mbrohej nga i njëjti avokat, veprimet e kryera prej të cilit gjatë ushtrimit të mbrojtjes së interesave të tij dhe të bashkëpandehurve të tjerë nuk rezultojnë të jenë vlerësuar nga gjykatat në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrimeve të tij. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, ka mbajtur qëndrim të shprehur për këto pretendime të kërkuesit, duke ushtruar funksionin e saj për kontrollin e respektimit e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se procesi nuk duket të jetë zhvilluar në cenim të së drejtës së kërkuesit për t'u mbrojtur, për rrjedhojë i vlerëson këto pretendime si haptazi të pabazuara. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për *cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur dhe të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* janë haptazi të pabazuara.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.